

VENDIM
Nr. 380, datë 11.6.2014

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 942, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE DHE TË
DOKUMENTACIONIT PËR MARRJEN E LEJEVE MINERARE NË ZONAT E
HAPURA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 29 e 30, pikat 1e 11, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 10 të vendimit nr. 942, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Pas shkronjës “ç” të shkronjës “A.1”, shtohet shkronja “ç/1”, me këtë përmbajtje:

“ ç/1. Në çdo rast, kërkuesi është i detyruar që, përveç një ose disa vërtetimeve që provojnë kapacitetin financiar, të përcaktuara në shkronjën “ç”, të paraqesë detyrimisht edhe një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të energjisë elektrike për kontratën/at e energjisë që ka kërkuesi, i regjistruar në Shqipëri. Mosplotësimi i këtij kushti përbën shkak për refuzimin e aplikimit, përveç rasteve kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”.

2. Pas shkronjës “ç” të shkronjës “B.1” shtohet shkronja “ç/1”, me këtë përmbajtje:

“ç/1. Në çdo rast, kërkuesi është i detyruar që, përveç një ose disa vërtetimeve që provojnë kapacitetin financiar, të përcaktuara në shkronjën “ç”, të paraqesë detyrimisht edhe një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të energjisë elektrike për kontratën/at e energjisë që ka kërkuesi, i regjistruar në Shqipëri. Mosplotësimi i këtij kushti përbën shkak për refuzimin e aplikimit, përveç rasteve kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama